Vendim nr. 298, datë 21.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 21.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 50 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ASTRIT DEMNERI, ARIANA PECANI, ZANA KUMI, LULJETA DALLIU, TEUTA DALLIU, MYRVETE DEMNERI, VILMA DEMNERI, AIDA DEMNERI, ADEM DEMNERI, AGIM DEMNERI, SHPRESA DEMNERI, FATBARDHA DEMNERI, FRENS DEMNERI, IBRAHIM TOSKA, AGRON DEMNERI, BRUNO BEJLERI, ROLAND DEMNERI, DASHAMIR TOSKA, MAJLINDA GEGA, SHKËLQIM DEMNERI, BLEND DEMNERI, ENGJELLUSHE SOTOMENI, FLORINDA PETERSEN, ILIR ALLUSHI,** përfaqësuar nga avokate Suela Mëneri, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2026-316 (57), datë 29.01.2026 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 15, 17, 18, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 142, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, paragrafi 1, dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe neni 1 i Protokollit nr.1 të saj; nenet 71/a, 71/b, 71/c, 71/d, 71/dh, 71/e dhe 76 të ligjit nr.**

8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit (pala paditëse në procesin gjyqësor) rezultojnë të jenë trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësve Xh.D., S.D., O.D. dhe R.D. Po kështu, rezulton se trashëgimtarëve të këtyre të fundit, me vendimin nr. 371, datë 19.12.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*), Bashkia Tiranë (*vendimi nr. 371/1996*) u është njohur pronësia për një tokë me sipërfaqe të përgjithshme 27.393 m², të ndodhur në Laprakë, nga e cila sipërfaqja prej 17.801 m², e zënë me ndërtime shtetërore, pallate banimi, sheshe dhe rrugë, është njohur e drejta e kompensimit, ndërsa për sipërfaqen prej 9.592 m² është njohur e drejta e kthimit. Prona rezulton e regjistruar në regjistrin hipotekar nr. 413, datë 14.12.1934, si dhe në atë nr. 165, datë 23.03.1934. Ky vendim i KKKP-së, Bashkisë Tiranë nuk është ekzekutuar për sa i takon së drejtës së trashëgimtarëve për kompensim.

2. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" (*ligji nr. 133/2015*), Agjencia e Trajtimit të Pronave (*ATP*) (e paditura në procesin gjyqësor) ka kryer vlerësimin financiar të vendimit nr. 371/1996, të cilin e ka publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. 17, datë 10.04.2018.

3. ATP-ja, me shkresën nr. 2928/1 prot., datë 26.04.2018 "Kthim përgjigjeje", drejtuar njërit prej paditësve, ka sqaruar se, referuar hartës së Institutit Gjeografik të Firences të vitit 1941, zëri kadastral i origjinës së sipërfaqes së njohur për kompensim ka qenë "truall" për 350 m² dhe "tokë bujqësore" për pjesën tjetër. Prona ndodhet në zonën kadastrale nr. 8310, për të cilën VKM-ja nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", ka miratuar vlerë vetëm për truallin në masën 31.219 lekë/m². Sipas ATP-së, zona kadastrale më e afërt gjeografikisht, për të cilën është miratuar vlerë për tokën bujqësore, është zona 3993, me vlerë 448 lekë/m². ATP-ja ka përllogaritur për sipërfaqen e njohur për kompensim 10.926.650 lekë për 350 m² truall dhe 7.818.048 lekë për 17.451 m² tokë bujqësore.

Duke vlerësuar se vlera e pronës së kthyer ishte më e madhe se vlera e pronës së njohur për kompensim, ATP-ja e ka konsideruar të kompensuar subjektin e shpronësuar. Pala paditëse e ka kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Apelit vlerësimin financiar të kryer nga ATP-ja.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 33 (86-2020-470), datë 21.02.2020, ka pranuar padinë dhe ka ndryshuar vlerësimin financiar të kryer nga ATP-ja për sipërfaqen 17.801 m² të njohur për kompensim me vendimin nr. 371/1996, duke e vlerësuar atë sipas zërit kadastral "truall", në shumën 555.729.419 lekë. Gjykata apelit ka vlerësuar se ATP-ja nuk ishte mbështetur në të dhënat e dokumentacionit ligjor për përcaktimin e zërit kadastral të origjinës së pronës. Sipas gjykatës së apelit, përshkrimi i pronës në vendimin e KKKP-së, Bashkisë Tiranë, i vlerësuar në harmoni me përfundimet e ekspertes së caktuar në gjykim, mbështeste përfundimin se prona në origjinë ndodhej në zonë urbane dhe se rezultonte pjesë e planit të miratuar të fshatit Littorio të vitit 1942, si truall për ndërtim. Po kështu, ajo kishte parashtruar se, sipas planvendosjes dhe gjeoreferimit me Planin e Tiranës me kufij të rinj, prona shtrihej brenda kufijve urbanë të qytetit të Tiranës, të miratuar më 03.10.1945. Në analizë të provave shkresore dhe të përfundimeve të aktit të ekspertimit, gjykata e apelit ka vlerësuar se e gjithë sipërfaqja e njohur për kompensim duhej të vlerësohej sipas zërit kadastral "truall". Për rrjedhojë, ajo gjykatë ka vlerësuar se konsiderimi i subjektit të shpronësuar si i kompensuar nga ATP-ja ishte pasojë e vlerësimit të sipërfaqes 17.451 m² si tokë bujqësore. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs Avokatura e Shtetit dhe ATP-ja.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 33 (86-2020-470), datë 21.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, për hetimin e plotë të çështjes dhe interpretimin e drejtë të ligjit material dhe procedural të zbatueshëm, pasi arsyetimi dhe përfundimi i arritur prej saj është rrjedhojë e interpretimit jo të drejtë të kërkesave të ligjit procedural, të cilat e bëjnë të cenueshëm atë vendim. Sipas Kolegjit Administrativ, konflikti gjyqësor lidhet me përcaktimin e zërit kadastral të pronës në kohën e shpronësimit. Gjykata e apelit e ka përcaktuar atë si "truall", duke u bazuar në pjesën e planit të përgjithshëm të fshatit Littorio të vitit 1942 dhe në pjesë nga plani mbështetës i qytetit të Tiranës i vitit 1953, ndërsa ATP-ja e ka kryer vlerësimin mbi bazën e hartës së Institutit Gjeografik të Firences të vitit 1941. Sipas Kolegjit Administrativ, lidhur me vlefshmërinë provuese të akteve për të përcaktuar zërin kadastral, gjykata e apelit nuk ka arsyetuar se përse ishte i gabuar vlerësimi i ATP-së dhe nuk u ka dhënë përgjigje në mënyrë shteruese pretendimeve të ATP-së dhe Avokaturës së Shtetit për zërin kadastral të pronës në kohën e shpronësimit. Kolegji

Administrativ ka vlerësuar se kriteret e vlerësimit janë përcaktuar shprehimisht nga ligjvënësi dhe se evidentimi i kohës së kryerjes së shpronësimit është përcaktues për mënyrën e procedimit të ATP-së në vlerësimin financiar të vendimit përfundimtar për kompensim. Po sipas Kolegjit Administrativ, nëse nuk provohet zëri kadastral i pronës në momentin e shpronësimit, pala paditëse përfiton nga efektet e vendimit nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata).* Kolegji Administrativ ka lënë detyrë se në rigjykimin e çështjes gjykata e apelit duhet të garantojë zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm: të kryhet cilësimi e saktë i fakteve dhe i rrethanave; të zbatohen drejt rregullat ligjore të barrës së provës; t'u japë përgjigje pretendimeve të palëve dhe të kryhet një analizë tërësore dhe objektive e provave për ta zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin dhe normat e tjera në fuqi që janë të detyrueshme të zbatohen. Po kështu, në rigjykimin e çështjes, gjykata e apelit duhet të rivlerësojë faktet, bazuar në kriteret e sipërcituara ligjore dhe në fund të japë vendim për zgjidhjen në themel të pretendimeve të paditësit.

6. Në datën 08.06.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të saj, është regjistruar në datën 12.06.2026.

7. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesve

8. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se nga vendimet e kundërshtuara u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

8.1. *Parimit të sigurisë juridike, të pritshmërive të ligjshme dhe të parashikueshmërisë së kontrollit gjyqësor*, pasi kërkuesit disponojnë një vendim përfundimtar të ish-KKKP-së, si dhe kanë ndjekur procedurat e rivlerësimit financiar sipas ligjit nr. 133/2015 dhe kanë marrë një vendim në favor të tyre nga Gjykata Administrative e Apelit. Pritshmëria e tyre e ligjshme është konsoliduar nëpërmjet vendimit përfundimtar, procedurave të rivlerësimit financiar dhe vendimit të gjykatës së apelit. Pas afro gjashtë vjetësh pritjeje për shqyrtimin e rekursit, Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në një

periudhë gjatë së cilës kuadri normativ dhe jurisprudencial kishte vijuar të evoluonte. Kthimi i çështjes për rigjykim i ka vendosur kërkuesit përsëri në gjendje pasigurie për elementin nga i cili varet masa e kompensimit.

8.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të shqyrtimit efektiv të pretendimeve thelbësore të palës*, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka hetuar çështjen e kohës së shpronësimit dhe të zërit kadastral të pronës. Nga procesverbali dhe regjistrimi audio i seancës së datës 18.02.2020 rezulton se gjykata ka kërkuar sqarime për kohën e shpronësimit, bazën dokumentare dhe metodologjinë e përdorur nga ATP-ja, ndërsa gjatë diskutimit të aktit të ekspertimit është zhvilluar debat kontradiktor ndërmjet gjykatës, ATP-së, Avokaturës së Shtetit dhe ekspertes gjyqësore. Megjithatë, vendimi i kundërshtuar nuk shpjegon se përse hetimi gjyqësor dhe debati kontradiktor i zhvilluar në gjykatën e apelit nuk përbën analizë të mjaftueshme dhe nuk lejon të identifikohet lidhja logjike ndërmjet materialit procedural dhe përfundimit të arritur. Edhe pse gjykata e apelit ka vlerësuar faktet dhe provat lidhur me kohën e shpronësimit dhe zërin kadastral të pronës, Kolegji Administrativ, nga njëra anë, ka vlerësuar se këto çështje nuk ishin analizuar në mënyrë të mjaftueshme dhe ka urdhëruar rigjykimin e çështjes, ndërsa, nga ana tjetër, ka arsyetuar se "në deduksion logjik" prona rezultonte tokë bujqësore jashtë vijës së verdhë të qytetit të Tiranës dhe ka identifikuar paraprakisht pasojat juridike në rast se zëri kadastral në kohën e shpronësimit nuk provohej. Kërkuesit nuk kundërshtojnë kompetencën e Gjykatës së Lartë për të interpretuar ligjin dhe për të dhënë udhëzime juridike detyruese, por mënyrën në të cilën janë kombinuar nevoja për hetim të mëtejshëm, vlerësimet mbi elementin kryesor të mosmarrëveshjes, identifikimi paraprak i pasojave juridike dhe udhëzimet për rigjykimin. Vendimi i Gjykatës së Lartë ngre dyshime nëse gjykatës së rigjykimit i është ruajtur hapësira reale dhe efektive e vlerësimit dhe nëse kontrolli kasacional është ushtruar në përputhje me garancitë e procesit të rregullt ligjor.

8.3. *Së drejtës së pronës*, pasi objekti i mosmarrëveshjes dhe përcaktimi i zërit kadastral të pronës në kohën e shpronësimit përbën elementin nga i cili varet drejtpërdrejt vlera ekonomike e së drejtës së kompensimit të kërkuesve. Për rrjedhojë, mangësitë në arsyetimin gjyqësor, respektimi i kufijve të kontrollit kasacional dhe sigurisë juridike nuk mbeten në planin procedural,

por ndikojnë në mbrojtjen efektive të interesit të tyre pasuror. Kolegji Administrativ, nga njëra anë, ka vlerësuar se gjykata e apelit nuk kishte zhvilluar një hetim të plotë dhe se çështja kërkonte rivlerësimin e fakteve dhe, nga ana tjetër, ka formuluar përfundime për zërin kadastral bujqësor të pronës dhe vendndodhjen e saj jashtë vijës së verdhë, si dhe ka përcaktuar paraprakisht pasojat juridike në rast të mosprovimit të zërit kadastral. Për rrjedhojë, kërkuesve u kanë lindur dyshime për neutralitetin procedural dhe efektivitetin e procedurës për përcaktimin e vlerës së kompensimit.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

9. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret paraprake të legjitimimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi edhe i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

11. Në rastin konkret, Kolegji do të ndalet në kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në kushtet kur kontrolli kushtetues ka një funksion

subsidiar, ai mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor të themelit. Gjykata ka theksuar se, në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vet individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime tek organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Po kështu, Gjykata ka pohuar se kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjykimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesit kanë kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, e cila ka prishur vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit dhe ka dërguar çështjen për rishqyrtim në po atë shkallë gjykimi, me tjetër trup gjykues. Kërkuesit kanë pretenduar se për shkak të kësaj vendimmarrjeje, atyre u janë cenuar parimi i sigurisë juridike dhe standardi i arsyetimit gjyqësor, të cilat kanë diktuar edhe cenimin e së drejtës së pronës.

14. Kolegji konstaton se lidhur me themelin e çështjes Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur në favor të kërkueseve duke pranuar padinë si të bazuar në prova dhe në ligj, në lidhje me vlerësimin financiar të kryer ndaj pronës së tyre nga ATP-ja, ndërsa Gjykata e Lartë, e vënë në lëvizje me rekursin e palës kundërshtare, e ka kthyer çështjen për rigjykim. Gjykata e Lartë ka evidentuar se gjykata e apelit nuk ka arsyetuar se përse ishte i gabuar vlerësimi i ATP-së për zërin kadastral të pronës dhe se nuk u ka dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të ATP-së dhe Avokaturës së Shtetit. Për këtë arsye, çështja është dërguar për rigjykim, me detyrën që gjykata e apelit të rivlerësojë faktet dhe provat dhe të vendosë për zgjidhjen në themel të pretendimeve të paditësve. Në rolin e gjykatës së ligjit, ajo ka vënë në dukje se mund të vendosë mbi themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet mbi bazën e të njëjtave fakte e të njëjtave prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe përbëjnë bazën e vendimit mbi të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Nga sa më lart, procesi gjyqësor për themelin e mosmarrëveshjes ende nuk ka përfunduar, pasi çështja do të rigjykohet në gjykatën e apelit, ndaj kërkuesit nuk kanë marrë ende një përgjigje përfundimtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

15. Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se cenimi i të drejtave themelore, përfshirë të drejtën për proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet përpara Gjykatës vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të parashikuara nga sistemi i zakonshëm i apelimeve, edhe kur procedurat gjyqësore paraprake sjellin një rëndim ose zgjatje të mëtejshme të cenimit të pretenduar (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe standardet kushtetuese të përmendura më sipër (*shih paragrafin 11 sipër*), vlerëson se kërkuesit mund t'i drejtohen eventualisht Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të kenë përfunduar shqyrtimin në themel të çështjes dhe të kenë dhënë një vendim përfundimtar. Vetëm në atë moment Gjykata mund të vlerësojë nëse zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë arbitrar ose nëse procesi, i marrë në tërësi, ka respektuar garancitë e nenit 42 të Kushtetutës. Për sa kohë që çështja është ende në rigjykim dhe procesi gjyqësor nuk ka përfunduar me një vendim përfundimtar, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesve janë të parakohshme dhe, për rrjedhojë, nuk mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues.

16. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor dhe të kufijve të kontrollit kasacional, pasi Kolegji Administrativ, ndonëse ka urdhëruar rigjykimin e çështjes për përcaktimin e zërit kadastral të pronës, ka arsyetuar se "në deduksion logjik" ajo rezultonte tokë bujqësore dhe ka identifikuar pasojat juridike në rast të mosprovimit të këtij zëri.

17. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji vëren se përdorimi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i togfjalëshit "në deduksion logjik" nuk mund të vlerësohet i shkëputur nga tërësia e arsyetimit të vendimit të tij dhe nga disponimi përfundimtar. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë nuk ka përcaktuar në mënyrë përfundimtare zërin kadastral të pronës në kohën e shpronësimit dhe as ka zgjidhur vetë mosmarrëveshjen në themel, por ka vlerësuar se çështjet që lidhen me kohën e shpronësimit dhe zërin kadastral të pronës nuk ishin hetuar dhe nuk ishin analizuar në mënyrë të mjaftueshme. Për këtë arsye, ajo e ka kthyer çështjen për rigjykim, me qëllim plotësimin e hetimit gjyqësor lidhur me këto elemente. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesve nuk qëndron.

18. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesve nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.